



Funded by
the European Union

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË STRATEGJISË SË UJËRAVE TË KOSOVËS 2017-2036



Promoting Universal
Access to **Clean Water**

Let's do it  **Peja!**

Shkurt, 2023

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.
Përmajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Let's Do It Peja, zbatues i projektit “Promovimi i
Qasjes Univerzale në Ujë të Pastër” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e
Bashkimit Evropian, Zyrës në Prishtinë.



Funded by
the European Union

**PËRMBLEDHJE E RAPORTIT PËR
MONITORIMIN E ZBATIMIT TË
STRATEGJISË SË UJËRAVE TË KOSOVËS
2017-2036**



Promoting Universal
Access to **Clean Water**

Let's do it  **Peja!**

Shkurtesat

ARPL	Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore
ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
BE	Bashkimi European
DKU	Direktiva Kornizë e Ujërave
FLAWS	Projekti: Nxitja dhe Shfrytëzimi i Mundësive për Sigurinë e Ujërave
IHMK	Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës
ISR	Indeksi Standard i Reshjeve
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
KNU	Këshilli Ndërministror për Ujëra
KRU	Kompania Rajonale e Ujit
KU	Kompania e Ujitjes
MASHT	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
ME	Ministria e Ekonomisë
MIRU	Menaxhimi i Integruar i Resurseve Ujore
MMPH	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik (tash Ministria e Ekonomisë)
NJZP	Njësia e Zbatimit të Projektit (anglisht: “Project Implementation Unit”)
PMPL	Plani i Menaxhimit të Pellgjeve Lumore
UA	Udhëzim Administrativ
UPF	Uji i Pafaturuar
VNSM	Vlerësimi i Ndikimit Social dhe Mjedisor

PËRMBLEDHJE E PROGRESIT DHE REKOMANDIME

Monitorimi i zbatimit të Strategjisë

Strategjia Shtetërore e Ujërave të Kosovës është dokument kryesor planifikues në fushën e ujërave i hartuar në bazë të Ligjit për Ujëra për periudhë kohore 20-vjeçare. Qëllimi i këtij dokumenti është që të ofrojë zhvillim të qëndrueshëm dhe të integruar të sektorit të ujërave duke i plotësuar nevojat për: furnizim me ujë, ujin për prodhimin e ushqimit, ujitje dhe bujqësi, industri, prodhim të energjisë, peshkim, turizëm, sport dhe rekreacion.

- Me Strategji janë përcaktuar 4 objektiva strategjike si vijon:

1) Shfrytëzimi i ujit

“Të ndahet dhe mbikëqyret në mënyrë të qëndrueshme e drejta për shfrytëzimin e burimeve ujore të Kosovës tek të gjithë shfrytëzuesit e ujit ashtuqë të garantohet për të gjithë qasja në ujë të pijshëm të sigurt për shëndetin dhe të maksimizohen përfitimet ekonomike nga përdorimet tjera të ujit, duke marrë në konsideratë ndryshimin e regjimeve hidrologjike, eliminimin e mungesës së ujit dhe duke respektuar parimin e menaxhimit të qëndrueshëm.”

2) Mbrojtja e ujërave

“Të rregulohen dhe mbikëqyren aktivitetet që rrisin presionin në mjedisin ujqor në mënyrë proporcionale, efiçiente dhe efektive, në mënyrë që të arrihen objektiva mjedisore të arsyetuara nga aspekti ekonomik për trupat e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore duke respektuar njëkohësisht parimet e menaxhimit të qëndrueshëm.”

3) Mbrojtja nga ujërat

“Të arrihen nivele të pranueshme të mbrojtjes së popullsisë dhe pronës nga efektet e dëmshme të ujërave, duke përfshirë vërshimet, rrëketë dhe erozionin në një mënyrë që është ekonomikisht e ekuilibruar dhe me kosto efektive.”

4) Qeverisja

“Të krijohet dhe të mirëmbahet një sistem i qeverisjes së ujit që është i drejtë, transparent, efikas, i koordinuar dhe me kapacitet të tillë profesional dhe teknik që të jetë në gjendje të mbështesë në mënyrë efektive arritjen e objektivave strategjike për shfrytëzimin e ujërave, mbrojtjen e ujërave dhe mbrojtjen nga ujërat, duke përfshirë zbatimin e një sistemi të informacionit të ujërave për të monitoruar, vlerësuar, interpretuar dhe informuar palët e interesuara për të gjitha aspektet e kësaj Strategjie.”

- Arritja e 4 objektivave strategjikë të Strategjisë është planifikuar të bëhet përmes **29 masave** specifike (10 për objektivin e parë, 8 për objektivin e dytë, 5 për objektivin e tretë, dhe 6 për objektivin e katërt). Për secilën prej masave janë përcaktuar veprimet për zbatimin e tyre, gjithsej **74 veprime** (31 për objektivin e parë, 15 për objektivin e dytë, 13 për të tretin dhe 20 për objektivin e katërt).
- Vlerësimi i zbatimit të Strategjisë është bërë për **secilin veprim** veç e veç, pastaj bazuar në zbatimin e veprimeve është vlerësuar se në çfarë shkalle janë zbatuar masat dhe

përfundimisht, bazuar në vlerësimin për masat e zbatuara është vlerësuar edhe shkalla e arritjes së objektivave strategjik. Vlerësimi është bërë duke u bazuar në të dhënat e ofruara nga institucionet dhe organizatat përgjegjëse në pyetësorët e dërguar për këtë qëllim; gjithashtu janë shfrytëzuar edhe dokumentet dhe raportet e disponueshme në internet të institucioneve relevante (si Agjencia e Statistikave të Kosovës, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës përfshirë insitucionet që janë në kuadër të kësaj Ministrie si Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore dhe Instituti Hidrometeorologjik, pastaj Autoriteti Rregullator për Shërbime të Ujit, Kompanitë Rajonale të Ujit, komunat etj.).

Vlerësimi sipas objektivave strategjikë dhe rekomandimet

(i) OBJEKTIVI STRATEGJIK 1: SHFRYTËZIMI I UJIT

Vlerësimi për 10 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektiv strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 3
- Progres i pjesshëm – 6
- Progres i vogël – 0
- Pa progres – 1

Ky është objektiv strategjik për të cilin ka pasur më shumë progres krahasuar me objektivat tjerë strategjikë. [Arritja e këtij objektiv strategjik është vlerësuar me $K=3.3^1$]

Progres substancial është vlerësuar se ka pasur në tri prej masave:

Masa 1.4: Zvogëlimi i shkallës së mospagesës për ujin e shfrytëzuar – KRU-të kanë arritur shkallën e arkëtimit të faturave në 96%, MMPHI ka rritur substancialisht shkallën e arkëtimit të pagesave ujore në dy vitet e fundit, Kompanitë e Ujitjes gjithashtu kanë shënuar rritje të konsiderueshme të shkallës së arkëtimit të faturave për ujin e furnizuar).

Masa 1.6: Arritja e përputhshmërisë me Direktivën e BE-së për Ujin e Pijshëm – Direktiva e Ujit të Pijshëm është transpozuar në legjislacionin kosovar, shkalla përputhshmërisë së cilësisë së ujit të furnizuar përmes sistemeve publike të ujësjellësit është mbi 98%, të gjitha KRU-të kanë laboratore të cilësisë së ujit – 2 prej tyre të akredituara, të tjerat në proces të akreditimit);

Masa 1.7: Programi i investimeve për sistemet e furnizimit me ujë (24.7 milion EUR për periudhën 2017-2021) – Janë tejkalluar investimet e planifikuara meqenëse janë investuar në total rreth 129 milion EUR (faza e VI-të e programit RWSSP për sistemet rurale në bashkëfinancim të Qeverisë së Kosovës me Qeverinë Zvicerane në vlerë 15.75 mil EUR, përmes KRU-ve nga të hyrat vetanake dhe grantet në vlerë 88.5 mil EUR, përmes komunave rreth 20 mil EUR, përmes MMPHI janë investuar rreth 5 mil EUR.).

¹ Koeficienti K është përlogaritur si mesatare aritmetikore e shkallës së zbatimit të masave duke i kuantifikuar progresin e zbatimit të masave si vijon: *progres substancial-5, progres i pjesshëm-3, progres i vogël-1, pa progres-0.*

Progres i pjesshëm është vlerësuar për shumicën e masave të këtij obektivi strategjik – 6 sish.


Progresi në zbatimin e këtyre masave nuk është plotësisht në pajtim me dinamikën dhe veprimet e planifikuara, dhe rrjedhimisht nevojitet angazhim më i madh në zbatimin e tyre. Kjo sidomos kur të kihet parasysh fakti se këto masa janë esencialisht të rëndësishme për sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm afatgjatë të popullatës dhe ekonomisë me ujë (siç janë: *Masa 1.1 Rritja e kapaciteteve për akumulimin dhe ruajtjen e resurseve ujore, Masa 1.2: Rritja e efikasitetit në shfrytëzimin e ujit, Masa 1.3: Sigurimi i kontrollit mbi të gjitha shfrytëzimet e resurseve ujore, Masa 1.5: Integrimi i sistemeve rurale dhe lokale në KRU, Masa 1.8: Optimizimi i mbulueshmërisë me sistem për ujitje, dhe Masa 1.10: Plani për menaxhimin e thatësirave*).

Pa progres është vlerësuar një prej masave të planifikuara:

Masa 1.9: Promovimi i shfrytëzimit të qëndrueshëm të ujit nga shfrytëzues tjerë – asnjëri prej veprimeve të planifikuara për këtë masë (Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për turizëm dhe rekreacion, Përgatitja e planit afatgjatë për shfrytëzimin e ujit për ferma të peshqve, Përgatitja e një strategjie për shfrytëzimin e qëndrueshëm të inerteve nga pellgjet lumore, Dhënia e lejeve të shfrytëzimit të ujit për hidrocentrale duke respektuar nevojat dhe të drejtat e shfrytëzuesve që gjenden në rrjedhën e poshtme) nuk është implementuar.

Rekomandohet që me prioritet të rritet dinamika dhe angazhimi i resurseve në zbatimin e masave dhe veprimeve për të cilat nuk ka pasur fare progres apo që ka pasur progres të pamjaftueshëm (*progres i pjesshëm*). Në veçanti, angazhim shtesë rekomandohet në lidhje me masat dhe veprimet që kanë të bëjnë me **shtimin e kapaciteteve për akumulimin e ujit si dhe rritjen e efikasitetit për shfrytëzimin e ujit**, kur të kihet parasysh se: (i) Kosova ka resurse modeste ujore, (ii) ndikimin negativ të ndryshimeve klimatike, dhe (iii) rëndësinë esenciale të ujit për zhvillim social dhe ekonomik.

Figura 1: Paraqitja grafike e progresit në përmbushjen e objektivit strategjik 1



(ii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 2: MBROJTJA E UJËRAVE

Vlerësimi për 8 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivit strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 2
- Progres i pjesshëm – 2
- Progres i vogël – 2
- Pa progres – 2

Progresi për këtë objektiv strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të masave dhe veprimeve, është më i vogël se sa progresi për objektivin strategjik 1. [Arritja e këtij objektivit strategjik është vlerësuar me K=2.25]

Progres substancial është vlerësuar se ka pasur në 2 prej masave:

Masa 2.4: Implementimi i trajtimit të ujërave të ndotura – Është rritur substancialisht shkalla e trajtimit të ujërave të ndotura, nga 1% në 11%. Janë finalizuar dhe janë lëshuar në funksion impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën. Janë në fazën e planifikimit dhe projektimit impiantet e trajtimit të ujërave

të ndotura për Prishtinën (përfshirë Obiliqin, Graçanicën dhe Fushë Kosovën), Gjilanin dhe Mitrovicën (përfshirë Vushtrrinë). Këto impiante janë në fazën e planifikimit dhe projektimit dhe planifikohet të kompletohen deri në vitin 2026. Është ndërtuar impianti i trajtimit të ujërave të ndotura në fshatin Orllan me qëllim të mbrojtjes së akumulimit të Batllavës.

Masa 2.5 Programi i investimeve për menaxhimin e ujërave të ndotura (46.2 mil. EUR, 2017-2021) – Janë kryer investime në impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura në vlerë mbi 60 milion EUR (ITUN për Prizrenin, Pejën dhe Gjakovën) që tejkalon shumën e planifikuar. Janë zgjidhur modalitetet e investimit për implementimin e investimeve në trajtimin e ujërave të ndotura në vlerë rreth 150 mil. EUR (ITUN për Prishtinën, Fushë Kosovën, Obiliqin, Graçanicën, Mitrovicën, Vushtrrinë dhe Gjilanin).

Progres i pjesshëm është vlerësuar për dy prej masave:

Masa 2.2: Zgjerimi i mbulueshmërisë me sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura – Mbulueshmëria me sisteme publike të grumbullimit të ujërave të ndotura ka arritur në 75% të popullsisë – prej tyre 65% menaxhohen nga KRU-të (në zonat urbane 97% ndërsa në zonat rurale 46%). Në periudhën 2018-2020 janë zbatuar 8 projekte përmes MMPH me të cilat janë ndërtuar sistemet e kanalizimit për 30 fshatra.

Masa 2.3: Përmirësimi dhe ruajtja e funksionalitetit të sistemeve ekzistuese të grumbullimit të ujërave të ndotura – Janë zbatuar projektet për rehabilitimin e rrjetit të kanalizimit të mbështetura nga KfW në Prizren, Pejë dhe Gjakovë në vlerë totale 17.5 mil. EUR. Është kompletuar studimi i fizibilitetit për sistemin e kanalizimit të rajonit të Prishtinës mbështetur nga KfW. Është në përgatitje projekti për përmirësimin e sistemit të kanalizimit në rajonin e Prishtinës (Prishtinë, Fushë Kosovë, Graçanicë, Obiliq dhe Podujevë) mbështetur nga KfW në vlerë rreth 70 mil. EUR.

Progres i vogël sa i përket zbatimit është vlerësuar për dy prej masave si vijon:

Masa 2.1: Kontrollimi i shkarkimeve ndotëse – Progresi i vetëm sa i përket kësaj mase është planin legjislativ: është miratuar nga MMPHI *Udhëzimi i ri Administrativ nr. 02/2022 për Vlerat Kufizuese të Shkarkimeve të Ujërave të Ndotura në Trupat Ujorë dhe në Kanalizimin Publik* me të cilin është transpozuar Direktiva Nr. 91/271/EEC për Trajtimin e Ujërave të Ndotura Urbane. Në anën tjetër, MMPHI nuk e ka krijuar ende një regjistër të plotë të shkarkimeve të ujërave të ndotura më trupat ujorë nga objektet industriale me karakteristikat e shkarkimeve. KRU-të, gjithashtu, nuk i kanë kompletuar regjistrat për shkarkimet e ujërave të ndotura industriale në kanalizimin publik.

Masa 2.6: Menaxhimi i llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura – Nuk është hartuar ende një strategji në nivel të shtetit për menaxhimin e llumit të kanalizimit. Në vend të kësaj, në vitin 2022 është iniciuar hartimi i planeve për menaxhimin e llumit nga trajtimi i ujërave të ndotura me vendim të Këshillit Ndërmnistror për Ujëra.

Pa progres janë vlerësuar dy prej masave të planifikuara:


Masa 2.7: Menaxhimi i ndotjes difuzive nga bujqësia – Nuk ka pasur asnjë progres: nuk janë hartuar udhëzimet për përdorimin e plehrave në bujqësi e as udhëzimet për përdorimin e biocideve nga MBPZHR.

Masa 2.8: Ulja e ndotjeve difuzive nga burimet jo-bujqësore – Nuk ka pasur asnjë progres: nuk është përgatitur nga MMPH regjistri i tokave të kontaminuara e as strategjia për rehabilitimin e tokave të kontaminuara.

Rekomandohet që:

- Të vazhdohet me dinamikën e planifikuar sa i përket investimeve në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura;
- Të shpejtohet dinamika e investimeve e ndërtimit të sistemeve të kanalizimit në zonat rurale;
- Të trajtohet si çështje me prioritet kontrollimi i shkarkimit të ndotësve dhe problemi i menaxhimit të llumit të kanalizimit (përfshirë hartimin e strategjisë për menaxhimin e llumit);
- Të adresohet në tërësinë e vet dhe përmes bashkëpunimit ndërinsitucional (MMPH me MBPZHR dhe komunat) problemi i ndotjes difuzive nga bujqësia dhe aktivitetet jo-bujqësore.

Figura 2: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 2



(iii) OBJEKTIVI STRATEGJIK 3: MBROJTJA NGA UJËRAT

Vlerësimi për 5 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivit strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 0
- Progres i pjesshëm – 2
- Progres i vogël – 2
- Pa progres – 1

Progresi për këtë objektiv strategjik, në kuptimin kuantitativ të zbatimit të masave dhe veprimeve, është më i vogli krahasuar me objektivat tjerë strategjikë. [Arritja e këtij objekтиви strategjik është vlerësuar me K=1.6]

Progres i pjesshëm është vlerësuar për dy prej masave:

Masa 3.2: Paralajmërimi i vërshimeve dhe menaxhimi i emergjencave – Progres në zbatimin e kesaj mase paraqet fakti se Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës e ka krijuar sistemin e paralajmërimit të hershëm të përmytjeve përmes ISR. Ky sistem duhet të avancohet dhe të lidhet me MeteoAlarm. Gjithashtu, procedurat për veprim në rast të vërshimeve janë përcaktuar me *UA nr. 19/2015 për Mbrojtjen nga Veprimet e Dëmshme të Ujërave*.

Masa 3.4: Sigurimi që të gjitha strukturave ekzistuese akumuluese janë të sigurta – Siguria e digave është adresuar nga MMPHI që ka zbatuar një projekt për vlerësimin e sigurisë së digave dhe rrezikun sizmik i cili është zbatuar në vitin 2021-2022. Në kuadër të këtij projekti janë trajnuar personeli i KRU për sigurinë e digave. Në anën tjetër, në vitin 2018 është rehabilituar diga e Përlepnicës. Poashtu, progres paraqet edhe nxjerrja e *Udhëzimit Administrativ Nr. 09/2017 për Projektimin, Ndërtimin dhe Shfrytëzimin e Digave* me të cilin janë përcaktuar përgjegjësitë institucionale për operimin dhe mirëmbajtjen e digave si dhe standardet e projektimit dhe ndërtimit.

Progres i vogël sa i përket zbatimit është vlerësuar për dy prej masave si vijon:

Masa 3.1: Planifikimi i menaxhimit të rrezikut nga vërshimet – Me këtë masë ishte paraparë hartimi i planeve të menaxhimit të rrezikut nga vërshimet dhe zbatimi i tyre. Kjo nuk është kryer deri tash. Një aktivitet dhe progres është realizuar nga viti 2020 kur është kryer kryer *vlerësimi paraprak i rrezikut nga përmytjet*, përmes një projekti të financuar nga donatorët në vlerë 0.6 mil. EUR. Gjithashtu, në vitin 2021 është filluar projekti për përgatitjen e *hartave të rrezikut nga përmytjet për të gjitha pellgjet lumore të Kosovës*, të cilat janë kompletuar ë vitin 2022 (vlera e projektit 2.5 mil. EUR).

Masa 3.3: Infrastruktura për parandalimin dhe mbrojtjen nga vërshimet – Në periudhën 2017-2021 janë realizuar investime të konsiderueshme përmes MMPHI dhe në bashkëfinancim me komunat në rregullimin e lumenjve – 33 projekte. Këto investime tejkalojnë investimet e parapara me Strategji për këtë qëllim në periudhën 2017-2021 në vlerë 4.3 mil. EUR. Asnjë komunë nuk ka plan për drenazhimin urban – sistemin e kanalizimit atmosferik. Investimet e fazës 2 bazuar në Planin e Menaxhimit të Rrezikut nga Vërshimet nuk kanë mundur të implementohen duke pasur parasysh se ky plan nuk është kompletuar ende.


Pa progres është vlerësuar një prej masave të planifikuara:

Masa 3.5: Menaxhimi i erozionit dhe rrëkeve – Asnjëri prej dy veprimeve të planifikuara në kuadër të kesaj mase nuk është realizuar: nuk janë (i) përgatitur dhe nuk janë (ii) zbatuar Planet për menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit.

Rekomandohet që:

- Të vazhdoen aktivitetet e planifikuara me Strategji sa i përket (i) sigurisë së digave, (ii) paralajmërimit të emergjencave, (iii) menaxhimit të rrezikut nga vërshimet;
- Të fillohet me punët në planifikimin dhe menaxhimin e rrëkeve dhe erozionit.

Figura 3: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 3



(iv)OBJEKTIVI STRATEGJIK 4: QEVERISJA

Vlerësimi për 6 masat e planifikuara për arritjen e këtij objektivi strategjik është si vijon:

- Progres substancial – 0
- Progres i pjesshëm – 3
- Progres i vogël – 3
- Pa progres – 0

[Arritja e këtij objektivi strategjik është vlerësuar me K=2]

Progres i pjesshëm është vlerësuar për 3 prej masave:

Masa 4.2: Tranzicioni drejt transpozimit të legjislacionit të BE – Me Ligjin për Ujëra dhe aktet nënligjore të miratuara nga MMPH gjatë periudhës 2017-2019 është transpozuar procesi i planifikimit të menaxhimit të resurseve ujore (PMPL, Planet e Vërshimeve,

afatet dhe përmbajtja etj.). Si progres vlerësohet edhe transpozimi i parimeve të planifikimit të menaxhimit të ujërave.

Masa 4.4: Menaxhimi i informacioneve – Është krijuar një sistem informativ i menaxhimit të ujërave në vitin 2021, i cili duhet të zhvillohet më tutje dhe të plotësohet me të dhëna. Nuk janë kompletuar procedurat formale të shkëmbimit të të dhënave relevante për menaxhimin e ujërave.

Masa 4.5: Edukimi në menaxhimin e ujërave – Përmes programit Menaxhimi i Integruar i Burimeve Ujore (MIRU) i financuar nga Qeveria e Zvicrës publikohet buletini Uji i Kosovës ku jepen informacione për qëllime të ndërgjegjësimit për çështjet për ujërat. Përmes këtij programi është planifikuar dhe pritet të fillojë në vitin 2023 programi Master në menaxhimin e resurseve ujore në kuadër të Universitetit “Hasan Prishtina”.

Progres i vogël sa i përket zbatimit është vlerësuar për 3 prej masave si vijon:

Masa 4.1: Legjislacioni për menaxhimin mjedisor të ujërave – Miratimi i secilit akt nënligjor përcjellet me vlerësimin e kostove për zbatim. Janë hartuar dhe miratuar një numër i konsiderueshëm i akteve nënligjore që kërkohen sipas Ligjit për Ujërat e Kosovës - gjashtë në periudhën 2017-2021. Nuk është hartuar një vlerësim i plotë i kostove për zbatimin e legjislacionit ujor dhe transpozimit të direktivave të ujit. Nuk është kompletuar një sistem për mbështetje të zbatimit të legjislacionit që do të përfshinte udhëzuesit për zbatimin e të gjitha akteve normative.

Masa 4.3: Përforcimet institucionale – Autoriteti i Rajonit të Pellgjeve Lumore (ARPL) është themeluar dhe prej vitit 2017 funksionon si departament brenda MMPHI. Personeli i ARPL nuk është kompletuar ende sipas strukturës organizative të tij. Nuk ka pasur progres të duhur në fuqizimin institucional të Institutit Hidrometeorologjik i Kosovës (IHMK): laboratorit ka mbetur i pa-akredituar, personeli nuk është rritur. Inspektorati Mjedisor nuk është kompletuar sipas SSHUK-nuk është rritur numri i inspektorëve me 5 inspektorë shtesë siç ishte planifikuar. Instituti për Ujëra nuk është themeluar.


Masa 4.6: Planifikimi për menaxhim të integruar të pellgjeve lumore – Plani për Menaxhimin e Pellgut të Lumit Drini i Bardhë është në fazën e finalizimit, me mbështetjen financiare nga Qeveria e Suedisë (SIDA). Planet për menaxhimin e tri pellgjeve tjera lumore (Lepenci, Ibri dhe Morava e Binçës) janë në fazën fillestare të planifikimit, me mbështetjen financiare të Qeverisë së Zvicrës përmes programit MIRU.

Rekomandohet që:

- Të kompletohet transpozimi i legjislacionit të ujërave të BE-së me Ligjin e ri për Ujëra dhe aktet nënligjore;
- Të kompletohet dhe të avansohet procesi i menaxhimit të informacioneve të ujërave;
- Të krijohet sistemi për mbështetjen e zbatimit të legjislacionit të ujërave (udhëzuesit për palët e interesit);

- Të kompletohet procesi i hartimit të planeve të menaxhimit të pellgjeve lumore dhe planeve të menaxhimit të vërshimeve.

Figura 4: Progresi i vlerësuar për zbatimin e masave të objektivit strategjik 4





**Funded by
the European Union**

Ky publikim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Let's Do It Peja, zbatues i projektit “Promovimi i Qasjes Univerzale në Ujë të Pastër” dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Zyra në Kosovë.

Hulumtimi është realizuar nga OJQ Let's Do It Peja
Adresa: Shtëpia e Kulturës, kati III
30000, Pejë, Kosovë
Email: letsdoitpeja@gmail.com
Tel:+383 49 124 548